


NE MBAJMË NDEZUR



PISHTARIN E DEMOKRACISË

KUVENDI ËSHTË POPULLI

LEART (11), DIELL (11), ALTIN (11), ELDON (11), YLL (11), ANDRA (11), MIHRIE (11), TRINA (11)



Unë Learti, bashkë me shokët dhe shoqet të cilët e kanë edhe emrin e shënuar lart, kemi punuar një artikull informues për ju. Shpresojmë që do t'iu pëlqej

Përshëndetje për juve, lexues të gazetës sonë. Sot kemi vendosur ta shkruajmë këtë artikull me temën „Kuvendi“. Përse vendosëm që të shkruajmë për këtë institucion? Ne vendosëm kështu, sepse ky institucion është shumë i rëndësishëm për jetët tona. Kuvendi na sjell jetë më të mirë, na sjell shkolla më të mira, na sjell edukim dhe arsim, si dhe na sjell ligje. Ligjet janë rregulla të shkruara, të cilat janë bërë në mënyrë që qytetarët t'i zbatojnë. Me zbatimin e këtyre ligjeve, ne i sigurojmë vetes jetë të mirë dhe të sigurt.

Sot ne mësuam për Kuvendin. Po ashtu, mësuam se aty punon Kryetari i Kuvendit, bashkë me deputetët. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë. Ata janë të zgjedhur nga populli i Kosovës. 100 prej tyre janë shqiptarë, 10 të tjerë janë serbë dhe 10 janë qytetarë të komuni-

teteve jo shumicë. Por, cilat janë komunitetet jo shumicë në Kosovë? Ato janë: komuniteti boshnjak, turk, romë, goran, egjiptian dhe ashkali. Ne biseduam dhe thamë se Kosova ka afërsisht 1.8 milion banorë. Gjatë bisedës sonë, ishte Ylli i cili tha: „Të gjithë këta banorë dallojnë mes vete. Ata dallojnë nga mosha, feja, gjinia, kultura, sjelljet, identiteti, raca dhe gjuha.“ Ne të tjerët u pajtuam me mendimin e Yllit. Kurse ishte Andra ajo e cila shtoi: „Edhe pse ne jemi të ndryshëm nga njëri-tjetri, të gjithë në mënyrë të barabartë gëzojmë mundësi të barabarta. Për shembull, pavarësisht nga etnia, të gjithë deputetët para ligjit konsiderohen të barabartë me të tjerët.“

Biseda jonë vazhdoi kur Mihria na tha: „Nëse sot unë do të fitoja të drejtën për votim, do të kërkoja nga kandidatët që të punonin vetëm për të mirën e popullit, në mënyrë që Kosova të mos ketë më probleme. Gjithashtu do të kërkoja që të respektoheshin të gjithë të drejtat e qytetarëve.“



Gazetarët e mirë shkruajnë mirë



Por, ata edhe mësojnë shumë

Artikulli vazhdon edhe më tej. Lexojeni atë dhe mësoni për ëndrrat e mia si deputete e ardhshme

Demokracia të sjell kënaqësi, sepse falë demokracisë ne kemi Kuvendin. Për neve ishte nder të mësonim sot për këtë institucion.

Nëse unë do të isha deputete e Kuvendit të Kosovës nuk do ta kisha edhe aq të lehtë, sepse puna e deputetes/it është tejet e rëndësishme. Unë do të zgjedh Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin e ministrat, të cilët punojnë në Qeverinë e Kosovës, si dhe Presidentin e shtetit. Të gjitha këto role janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e demokracisë së vendit tonë. Bashkë me ta ne ulemi në një sallë të madhe dhe bisedojmë. Këto takime quhen mbledhje plenare.

Po ashtu, mua si deputete më duhet të flas në emrin e popullit dhe të përfaqësoj nevojat e tij. Sjelljet raciste dhe diskriminuese nuk duhet të lejohen në Kuvend, e jo vetëm. Ato nuk lejohen askund në Kosovë. Unë do të votoja për ligjet më të mira, po të isha deputete. Kjo pasi që ligjet e miratuara nga ne do të ndikonin thellësisht jetën e qytetarëve të mi. Si deputete unë nuk përfaqësoj vetëm votuesit, të cilët më kanë dhënë votat e tyre. Unë përfaqësoj të gjithë qytetarët pa dallim. Këtu përfshihen edhe qytetarët e vegjël, të cilët janë nën moshën 18 vjeçare. Janë ata e ardhmja jonë, prandaj për ta ne punojmë në mënyrë sa më demokratike.



Ani pse të ndryshëm, të gjithë punojmë për më të mirën



Demokracia ndriçon ngado



Banorët e Tokës janë paqësor dhe të dashur me njëri-tjetrin



Duke bashkëpunuar ndërtojmë ardhmërinë e bukur




Për çdo individ ka hapësirë për kontributin e tij



Zemrat na rrahin për shtetin tonë demokratik

VENDIMET TONA, ZGJEDHJET TONA

RION (11), DRITA (11), ERIN (12), AMELIA (11), JON F. (12), ALBIONA (12), ORIND (11), JON S. (11)



Sot rikujtuam disa momente shumë të mira të cilat vetë ne i kemi përjetuar. E ato janë zgjedhjet që ne i kemi bërë ndër vite

Në këtë artikull do të flasim për zgjedhjet dhe llojet e zgjedhjeve. Por, në fillim do të japim disa shembuj, të cilët lidhen me zgjedhjet që ne kemi bërë në jetën tonë të përditshme.

Neve na u është dhënë rasti të zgjedhim mësimdhënësin, për të cilin ne mendojmë se është më i miri. Mirëpo, pa dyshim që na u janë kërkuar edhe arsyet për zgjedhjen tonë. Secili prej nesh, në mënyrën tonë, kemi treguar arsyet tona për zgjedhjen e mësimdhënësit të preferuar. Rasti tjetër është ku në një fletë, kujdestarja e klasës na ka dhënë disa lëndë. Ne të gjithë është dashur ta zgjedhim njëren prej tyre, si lëndë zgjedhore për vitin e ardhshëm. Ajo lëndë që mori më së shumti vota është zgjedhur si lëndë zgjedhore.

Në shkollën tonë, gjithashtu, është bërë zgjedhja e nxënësve më të mirë në klasë. Arsimtarët janë mbledhur dhe secili prej tyre ka votuar për zgjedhjen e nxënësit më të mirë dhe më të edukuar të klasës.

Siç e përmendëm në fillim të artikullit, sot po e shkruajmë këtë artikull për zgjedhjet dhe llojet e zgjedhjeve në vendin tonë. Ato janë: zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet qendrore. Zgjedhjet lokale janë kur qytetarët zgjedhin Kryetarin dhe asamblistët e një komune të caktuar. Detyrë e Kryetarit të Komunës është zgjidhja e problemeve të qytetarëve në komunën e tij, në mënyrë

që t'ua lehtësojë jetën qytetarëve të vet. Kurse, detyra e asamblistëve është që t'i ndihmojnë Kryetarit që së bashku t'i zgjidhin problemet e qytetarëve.


Zgjedhjet qendrore janë kur të gjithë qytetarët e Kosovës, votojnë për zgjedhjen e deputetëve të Kosovës. Moshë nga kur ne mund të marrim pjesë në procesin zgjedhor është moshë 18 vjeçare. Detyra e deputetëve është t'i përfaqësojnë interesat dhe kërkesat e qytetarëve të Kosovës. Sot e kuptuam një gjë shumë të rëndësishme, se zgjedhjet në demokraci kanë një rol të theksuar. Po të mos kishte zgjedhje, ne si qytetarë nuk do të kishim mundësinë që vetë ne t'i përcaktojmë përfaqësuesit e shtetit tonë. T'i vlerësojmë të drejtat që ne i kemi dhe t'i shfrytëzojmë ato për të mirën e vendit tonë.



Jemi gazetarë të ndershëm dhe shumë të përgjegjshëm

LIDHJA NË MES TË DEMOKRACISË DHE MEDIAS


FLORENT (12), KLESTI (11), BESIM (11), DIAR (11), DONAT (12), JONILA (11), ERINA (12), LEONITA (12)



Media dhe demokracia kanë lidhje në mes vete. Përmes medias ne informohemi dhe jemi në rrjedhë për shumicën e gjërave që ndodhin në vendin tonë dhe në vendet e tjera

Qytetarë të nderuar, ne si gazetarë të demokracisë kemi kënaqësinë t'iu njoftojmë se përmes medias njerëzit mund të jenë në hap me kohën. Me këtë nënkuptojmë se çdo herë mund të marrim informata për ngjarjet që ndodhin brenda dhe jashtë vendit. E ajo që

e procesit zgjedhor, ku qytetarët marrin informacione për kandidatët më të mirë për ta udhëhequr vendin. Vlen të theksohet se, kemi media të shkruara dhe media elektronike. Ne si nxënës jemi përfitues të dy llojeve të medias. Kohëve të fundit më së shumti jemi duke përdorur median elektronike dhe jemi duke e përdorur atë për të bërë hulumtime rreth temave të ndryshme shkollore. Përfitimi nga ky lloj i medias ekziston ngase ne kemi qasje në informata dhe në zbulimet e fundit që janë bërë. Kjo me të vërtetë është mrekulli. Por, të qenurit selektiv në marrjen e informatave përmes medias është mjaft e rëndësishme. Jo çdo gjë që paraqitet aty është e vërtetë. Vetëdijësimi i qytetarëve për këtë aspekt, luan rol primar për të krijuar me të vërtetë një shoqëri me vlera demokratike. Ju jeni ata që e ndërtoni dhe e zhvillonin demokracinë. Ne kemi besim tek ju dhe vendimet që merrni si popull.



Informimi drejtë i bën qytetarët të informuar mirë

është më e rëndësishmja rreth medias, është lidhshmëria e saj me sistemin demokratik të qeverisjes. A thua vallë pse ekziston kjo ndërlidhje?

Si media, ashtu edhe demokracia, lehtësojnë punën e njëra-tjetrës. Për shembull, përmes rrjeteve të ndryshme sociale dhe programeve të ndryshme televizive, informohemi se si funksionon demokracia në vendin tonë dhe në vende të tjera. Rast të tillë kemi mbajtur



Hulumtuesit e vegjël



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Ismail Qemali“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë